



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
BORDI I AKREDITIMIT**

# **Manual**

**Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet  
pyetësorit kombëtar të studentëve**

**ASCAL**

*Mbështetur dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit*

## Përmbajtja

<b>1. Hyrje</b> .....	3
<b>2.Qëllimi dhe objektivat kryesore për realizimin e SKS</b> .....	4
<b>3.Institucionet përgjegjëse</b> .....	5
<b>3.1. Bordi i Akreditimit, BA</b> .....	5
<b>3.2. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL</b> .....	5
<b>3.3. Institucionet e arsimit të lartë, IAL</b> .....	6
<b>3.4. Këshillat e studentëve, KS</b> .....	6
<b>3.5. Grupi i punës dhe koordinatori i procesit, GP dhe KP</b> .....	6
<b>3.6. Koordinator i institucional për zhvillimin e SKS</b> .....	7
<b>4. Zhvillimi dhe përmbajtja e sondazhit</b> .....	8
<b>4.1. Metodologjia e vlerësimit nëpërmjet SKS</b> .....	8
<b>4.2.Fushat e vlerësimit dhe indikatorët</b> .....	8
<b>4.3. Përmbajtja e sondazhit</b> .....	9
<b>4.4. Fazat e zhvillimit të SKS, procedura hap pas hapi</b> .....	12
<b>5. Administrimi dhe menaxhimi i të dhënave, analiza dhe rezultate</b> .....	16
<b>5.1.Të dhënat dhe baza e të dhënave</b> .....	16
<b>5.2. Transparenca, anonimatit dhe konfidencialiteti</b> .....	16
<b>5.3.Përpunimi paraprak dhe analiza e rezultateve</b> .....	17
<b>5.4.Rezultatet dhe vlerësimi</b> .....	17
<b>5.5.Rezultatet analitike përçdo IAL</b> .....	18
<b>5.6. Raporti përmbledhës</b> .....	18
<b>6. Shqyrtimi, vendimmarrja dhe publikimi i rezultateve të SKS</b> .....	19
<b>6.1 Shqyrtimi nga BA</b> .....	19
<b>6.2. Publikimi i rezultateve</b> .....	19
<b>7. Përkufizime dhe shkurtime</b> .....	20

# 1. Hyrje

Bazuar në ligjin nr. 80/15, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodologji është e përhapur në mjaft vende me arsim të lartë të konsoliduar dhe përdoret jo vetëm për këtë qëllim por për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet vlerësimit në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, proces i cili finalizohet me vendimmarrjen përfundimtare të akreditimit nga Bordi i Akreditimit. Pas akreditimit të parë ose periodik, është e nevojshme garantimi i standardeve të cilësisë në IAL nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të tyre nga institucionet e arsimit të lartë.

SKS në asnjë rast nuk do të zëvendësojë apo mbivendoset me procesin e akreditimit por ka si qëllim kryesor mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga janë studentët.

Nëpërmjet SKS, ASCAL dhe BA do të vlerësojnë se në çfarë mase institucionet zbatojnë standardet e cilësisë, parë me syrin e studentëve. Procesi do të kryhet në mënyrë periodike çdo tre vjet, por mund të zhvillohet edhe në periudha ndërmjetëse për vlerësime specifike kur kërkohet nga Bordi i Akreditimit ose ministri përgjegjëse për arsimin e lartë, në kuadër të analizave kombëtare në arsimin e lartë, për politikëbërjen, etj. Procesi është anonim dhe bazohet tërësisht në opinionin individual të studentëve për institucionet. Në asnjë rast, mendimet, përgjigjet, opinionet apo informacionet e dhëna individualisht, nuk do të jenë objekt i diskutimit, analizës dhe referencës rast pas rasti. Të dhënat dhe informacionet e marra do të përpunohen statistikisht me anën e programeve kompjuterike dhe do të përdoren në mënyrë të tillë për qëllimet e sipërcituara pa referenca individuale.

Në përfundim të procesit hartohet raporti analitik me rezultatet e pyetësorëve për çdo IAL, shoqëruar me analizat përkatëse si dhe analiza krahasuese për indikatorë të ndryshëm përkundrejt interesit publik apo të politikëbërjes. Ky raport bëhet publik dhe i vihet në dispozicion Bordit të Akreditimit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë në kuadër të vendimmarrjes dhe politikëbërjes. Realizimi i SKS është detyrim ligjor në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe për këtë arsye këtij procesi do t'inhenshtrohen të gjitha IAL që operojnë në Republikën e Shqipërisë apo filiale të institucioneve të huaja të licencuara në vendin tonë.

Ky manual i përgatitur nga ASCAL dhe miratuar nga BA, është pjesë e "Kodit të Cilësisë" në arsimin e lartë. Ai përmban në mënyrë të detajuar të gjitha hapat, proceset, metodologjinë që do të përdoret në kuadër të realizimit të SKS. Çdo rishikim apo ndryshim në përmbajtje të tij, është objekt diskutimi nga ASCAL, BA dhe IAL dhe miratohet nga Bordi i Akreditimit.

Plani kohor i zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve, miratohet nga Bordi i Akreditimit periodikisht, për vitin akademik në të cilin ai do të zhvillohet.

## 2. Qëllimi dhe objektivat kryesore për realizimin e SKS

Bazuar në ligjin nr. 80/15, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS).

SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave, nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve. Po ashtu, me anën e këtij sondazhi, do të vlerësohen edhe aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit të IAL në kuadër të vendimmarrjes dhe politikëbërjes në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Objektivat kryesore të SKS janë:

- Të japë në mënyrë periodike informacione reale e të besueshme për ASCAL, BA dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin, për cilësinë e arsimit të lartë, bazuar tek mendimi dhe opinioni i studentëve
- Të ndihmojë vendimmarrjen dhe politikëbërjen në fushën e arsimit me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë
- Të ndihmojë vetë institucionet e arsimit të lartë në përmirësimin e funksionimit dhe të rritjes së cilësisë tyre
- Të japë informacionet e nevojshme drejtuesve të institucioneve, administratorëve, për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve, bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve
- Të informojë me të dhëna të besueshme, studentët aktualë, me cilësinë e arsimit të lartë në institucionet ku ata studiojnë. Po ashtu synon të ndihmojë studentët e rinj me informacione për cilësinë e mësimdhënies në IAL.
- Të informojë publikun në tërësi për cilësinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Sondazhe të ngjashme me SKS mund të zhvillohen kur iniciohen nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë për qëllime specifike vlerësimi në fushën e arsimit të lartë.

### 3. Institucionet përgjegjëse

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet SKS kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë dhe bazohet në praktikat më të mira të ndjekura në vendet e zhvilluara. Meqënëse është një proces i rëndësishëm, realizimi i tij kërkon angazhimin dhe kontributin e disa institucioneve që janë pjesë e arsimit të lartë:

#### 3.1. Bordi i Akreditimit, BA

Bordi i Akreditimit është organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 15.02.2017, "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë*", BA miraton metodologjinë dhe instrumentet e SKS të propozuar nga ASCAL. Po ashtu, bazuar në këtë vendim, BA shqyrton raportet përfundimtare të SKS në kuadër të vendimmarrjes para publikimit të tyre.

Bordi i Akreditimit me propozim të ASCAL, shqyrton dhe miraton vendim të posaçëm datën e nisjes së procesit të SKS, periudhën dhe afatet e zhvillimit të tij. Ky vendim u përcillet të gjitha institucioneve të arsimit të lartë. Po ashtu, BA shqyrton metodologjinë, procedurën / manualin e propozuar nga ASCAL ose miraton ndryshimet eventuale në manualin ekzistues. BA, informohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e SKS. Në përfundim të procesit, BA analizon rezultatet paraprake të vëna në dispozicion nga ASCAL dhe miraton raportin përfundimtar të procesit. Në rast problematikash, propozon ndryshime/ përmirësime të Manualit, procedurës, kuadrit ligjor dhe politikëbërjes për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë. BA, në bazë të rezultateve të SKS, kur nuk garantohet cilësia në mësimdhënie, kërkon nga ASCAL nisjen e proceseve të ndryshme të monitorimit në institucione të caktuara. Rezultatet e SKS, raporti analitik, vendimmarrja dhe rekomandimet e BA, bëhen publike në përfundim të procesit.

#### 3.2. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të Nenit 104 Sigurimi i jashtëm i cilësisë, të Ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, ka një nga detyrat kryesore, procesin e vlerësimit të mësimdhënies, çdo tre vjet dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme institucionet e arsimit të lartë, përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

ASCAL është institucioni përgjegjës që harton procedurën, metodologjinë dhe instrumentet për zhvillimin e SKS.

Bazuar në planin e punës, ASCAL harton kalendarin e aktiviteteve dhe planin e veprimtarive për zhvillimin e SKS. Ky plan i detajuar i propozohet BA për t'u miratuar dhe zhvilluar në vitin pasardhës. BA pasi shqyrton planin e propozuar, miraton ose propozon ndryshime eventuale të tij. Në çdo rast, BA me vendim të posaçëm, miraton planin dhe kalendarin e aktiviteteve dhe ngarkon ASCAL për zhvillimin e tij. Agjenciabën publik planin e miratuar.

Titullari i ASCAL ngre Grupin e Punës (GP) dhe cakton koordinatoren për zhvillimin e SKS, informon institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe/ose këshillat studentore dhe bën publik

planin e detajuar të aktiviteteve. GP, bazuar në këtë Manual, harton procedurën e zhvillimit të SKS dhemiraton draft pyetësorët. ASCAL dhe GP është përgjegjës për zhvillimin e SKS në përputhje me procedurën e miratuar. Koordinatorin informon në mënyrë periodike për ecurinë dhe problematikat e SKS, titullarin e Agjencisë dhe BA.ASCAL garanton ecurinë e procesit duke vënë në dispozicion të GP, infrastrukturën e nevojshme logjistike, burimet njerëzore dhe financiare.

### **3.3. Institucionet e arsimit të lartë, IAL**

Të gjitha IAL që operojnë në Republikën e Shqipërisë, kanë detyrim ligjor t'i nënshtrohen SKS, sipas përcaktimeve të këtij manuali. IAL pas marrjes së njoftimit zyrtar për nisjen e procesit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet SKS, konfirmojnë pjesëmarrjen në të si dhe vënë në funksion të procesit të gjitha kapacitetet e nevojshme logjistike e humane që disponojnë. Institucionet, nëpërmjet koordinatorit institucional, vënë në dispozicion të ASCAL listën e plotë të studentëve dhe adresat elektronike (e-mail). Gjatë fazës së plotësimit të pyetësorëve, IAL vënë në dispozicion të studentëve dhe procesit, salla dhe laboratorë informatike në mënyrë që studentët të mund të plotësojnë pyetësorët. Në fillim të çdo viti akademik, IAL vënë në dispozicion të ASCAL kontaktet zyrtare të drejtuesëve të këshillave studentore dhe ndihmon ato të kryejnë takime informuese me studentët gjatë fazës së zhvillimit të SKS.

### **3.4. Këshillat e studentëve, KS**

SKS është proces i cili ka për bazë studentin. Bazuar në LAL, në çdo institucion të arsimit të lartë, studentët duhet të jenë organizuar dhe përfaqësuar nga Këshillat Studentorë. IAL mbështesin organizimin dhe funksionimin e tyre në përputhje me këtë ligj. ASCAL bashkëpunon ngushtësisht me KS në institucionet e arsimit të lartë dhe me Këshillin Kombëtar të Studentëve (KKS). KS në çdo IAL, informohen për nisjen e procesit të vlerësimit të mësimdhënies nëpërmjet SKS.

ASCAL organizon takime informuese dhe diskutimi me përfaqësi të studentëve. Takimet mund të organizohen edhe në institucionet e arsimit të lartë në rastet kur kërkohen nga KS, me qëllim informimin dhe trajnimin për aspekte teknike të studentëve. ASCAL para finalizimit të pyetësorëve, diskuton me KS dhe studentët, formatin e pyetësorëve<sup>1</sup>, fushat e vlerësimit, indikatorët dhe kriteret e vlerësimit, metodologjinë dhe analizën e rezultateve finale. Në përfundim të kësaj faze, çdo KS-së e IAL përgatit propozimet eventuale për ndryshime dhe i dërgon ato zyrtarisht (në rrugë elektronike ose postare) në ASCAL. GP shqyrton të gjitha propozimet dhe i reflekton ato në versionin përfundimtar të pyetësorëve. Këshillat studentore kanë detyrim informimin e të gjithë studentëve për rëndësinë e procesit, përgjegjësinë ndaj institucionit për të dhënë përgjigje të sakta dhe reale, procedurën e plotësimit si dhe informimin rezultatet përfundimtare.

### **3.5. Grupi i punës dhe koordinatori i procesit, GP dhe KP**

Me Urdhër të titullarit të ASCAL, ngrihet Grupi i Punës dhe caktohet Koordinatorin i Procesit i cili do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe ecurinë e zhvillimit të SKS. Në përbërje të GP,

---

<sup>1</sup>Shembuj pyetjesh dhe pyetësorësh

përveç stafit të ASCAL, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të BA apo ekspertë të fushës. Detyrat kryesore të GP dhe KP janë:

- GP harton procedurën e detajuar të vlerësimit e cila bazohet në këtë Manual dhe në Kodin e Cilësisë;
- Harton planin e punës me aktivitetet dhe dokumentacionin paraprak të nevojshëm për realizimin e SKS;
- Harton draft pyetësorët e SKS dhe i diskuton ato me përfaqësues të KS dhe BA dhe finalizon versionin përfundimtar të tyre;
- Përgatit platformën elektronike të pyetësorëve së bashku me stafin e ASCAL. GP garanton anonimat, sigurinë dhe *back-up*-in e të dhënave ;
- Përgatit versionin *online* të pyetësorëve dhe i teston ato para shpërndarjes së tyre. ASCAL mund të angazhojë edhe kompani të specializuara në fushën e IT dhe sondazheve;
- Mbledh kontaktet e studentëve për çdo IAL dhe i përgatit ato për procesin;
- Analizon rastet kur SKS nuk mund të zhvillohet për shkak të numrit të ulët të studentëve apo pjesëmarrjes së ulët në SKS;
- Përgatit materiale informuese dhe trajnuese për studentët dhe ua shpërndan ato gjatë takimeve dhe diskutimeve;
- Bëntë aksesueshëm SKS në mënyrë individuale në përputhje me datat e zhvillimit dhe planin e miratuar. Gjatë periudhës së plotësisimit, GP asiston studentët për problematika të hasura gjatë procesit. Çdo veprimtari dokumentohet në formë elektronike dhe shkresore;
- Informon titullarin e ASCAL dhe BA për ecurinë e SKS apo specifika/problematika që hasen gjatë procesit;
- Mbledh të gjitha rezultatet e pyetësorëve për çdo IAL;
- Analizon, përpunon rezultatet me metoda e programe statistikore të miratuara paraprakisht;
- Përgatit dhe finalizon rezultatet individuale të çdo IAL;
- Harton dhe finalizon raportin analitik, përmbledhës, të procesit me rezultate krahasuese për të gjithë indikatorët dhe kriteret e dhëna në pyetësorët e SKS;
- Përgatit dokumentacionin përfundimtar për shqyrtim dhe diskutim nga Bordi i Akreditimit;
- Publikon rezultatet dhe raportin analitik pas shqyrtimit nga BA në portalin *online* për akses nga publiku. Dërgon një kopje të raportit në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

### **3.6. Koordinatori institucional për zhvillimin e SKS**

Pasi IAL merr njoftimin zyrtar për fillimin e procesit për zhvillimit e SKS, ASCAL hap procedura të veçanta në sistemin e menaxhimit ku secili KI ka akses, merr informacion, jep informacione, dokumente gjatë gjithë fazës së procesit. Koordinatori institucional është person kontakti midis IAL dhe Këshillit Studentor për sa i përket informimit të tyre. KI vihet në dispozicion të studentëve duke marrë në konsideratë kërkesat e tyre për suport gjatë fazës së zhvillimit të sondazhit.

## 4. Zhvillimi dhe përmbajtja e sondazhit

### 4.1. Metodologjia e vlerësimit nëpërmjet SKS

Marrja e mendimit dhe opinionit të studentëve për qëllime vlerësimi të institucioneve të arsimit të lartë apo aspekte të veçanta është një nga praktikatat më të përhapura që aplikohet nga institucionet e arsimit të lartë apo organizmat të profilizuar në vende të ndryshme. Meqenëse është një proces i cili bazohet mbi mendime dhe opinione të studentëve për institucionet ku ata janë pjesë dhe studiojnë, kriteri parësor për të qënë pjesë e këtij vlerësimi, duhet që studenti të ketë njohuri themelore për institucionin e vet dhe të japë mendimin e tij të pavarur dhe të pandikuar nga rrethanat apo opinionet e tjera. Bazuar në qëllimin e SKS, rezultatet e tij nuk kanë fuqi vendimmarrëse por janë pjesë e analizave, propozimeve, sugjerimeve dhe ndryshimeve me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Pyetësorët e vlerësimit të mësimdhënies nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve nuk anashkalojnë dhe mbivendoset me proceset e tjera të sigurimit të cilësisë. Për këtë arsye procesi synon të jetë plotësues dhe ndihmës në funksion të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Procesi bazohet në metodologjinë standarde të zhvillimit të sondazheve, ku në bazë të fushës së vlerësimit, informacionet që kërkohen dhe qëllimi për të cilin kryhet, përgatiten indikatorët, dhe pyetjet për çdo kategori. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve, mund të mblidhen të dhëna cilësore dhe/ose sasore të cilat kuantifikohen dhe analizohen me programe statistikore. Grupi më i madh i pyetjeve do të jetë në formatin *mendim për...*, *vlerësim për...*, *dakordësi për ...*, ku studenti jep vlerësimin nga 1 në 5 duke filluar nga vlerësimi minimal në vlerësimin maksimal. Në rastet kur kërkohet mendim apo përgjigjet janë në formatin "*text/fjalë*", përgjigjet kuantifikohen për qëllim përpunimi statistikor ose analiza cilësore. Rezultati final bazohet mbi përpunimin e të gjitha përgjigjeve/mendimeve të dhëna nga të gjithë pjesëmarrësit dhe nuk kryhet rast pas rasti. ASCAL nuk analizon përgjigjet individuale të pjesëmarrësve por përgjigja bëhet pjesë e rezultatit të përgjithshëm.

ASCAL synon që pjesëmarrja në SKS të jetë maksimale ku çdo student të shprehë mendimin e vet për institucionin ku studion. Gjithsesi, në të gjitha IAL që kanë numër më të madh se 500 studentë, SKS duhet të plotësohet në mënyrë të plotë nga të paktën 10 % e numrit total të studentëve. Në rastet kur institucioni i arsimit të lartë ka numër të vogël studentësh, ( $50 < nr < 500$ ), numri i studentëve që duhet të plotësojnë pyetësorin në raport me numrin total duhet të jetë  $> 50\%$ . Në rastet kur numri i studentëve është më i vogël se 50, ASCAL nuk kryhen analizë statistikore të rezultateve por analizohen të dhënat në mënyrë anonime por jo me programe statistikore. Në këtë rast përgjigjet e studentëve përdoren vetëm për analizën e të dhënave në nivel kombëtar për raportin përfundimtar analitik.

Pyetësori zhvillohet *online* nëpërmjet platformave që ASCAL disponon dhe zhvillon për këtë qëllim. Informacionet e mbledhura dhe arkivuara, procedohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr 48/2012 dhe ligjin 120/2014.

### 4.2. Fushat e vlerësimit dhe indikatorët

Vlerësimi nëpërmjet SKS bazohet në të njëjtat fusha vlerësimi të parashikuara në Standardet e Cilësisë për vlerësimin në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, pjesë e Kodit



të Cilësisë në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në këto standarde, fushat e vlerësimit në të cilat do të fokusohen indikatorët e vlerësimit dhe pyetjet në përmbajtje të pyetësorit janë 6.

1. Organizimi i institucionit, menaxhimi dhe funksionimi i tij
2. Burimet
3. Kurrikulat, përmbajtja dhe përditësimi
4. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi
5. Aktiviteti kërkimor, projekte, studime, botime
6. Studentët dhe mbështetja e tyre

Të njëjtat fusha vlerësimi do të zbatohen për të gjitha institucione që do të nënshtrohen vlerësimit të mësimdhënies pavarësisht nga madhësia, historiku apo statusi i tyre.

Në rastet kur Bordi i Akreditimit ose/dheministria përgjegjëse për arsimin e lartë inicion procese vlerësimi, atëherë fushat e vlerësimit mund të ndryshojnë në varësi të qëllimit për të cilin do të zhvillohet sondazhi.

Çdo fushë vlerësimi përmban njëgrup indikatorësh dhe çdo indikator përmban pyetjet specifike që lidhen me atëkategori.

### **4.3. Përmbajtja e sondazhit**

SKS apo sondazhe të tjera të cilët organizohen nga ASCAL në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe Këshillat Studentorë, janë mekanizma për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e lartë. Ato realizohen në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë, ligjin për të drejtën e informimit dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet e tjera nënligjore, në funksion të bazës ligjore të sipërcituar. Në këtë kuptim, përmbajtja e SKS është në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave primare që ka SKS. Për këtë arsye, ASCAL garanton përmbajtjen, sigurinë e të dhënave, transparencë në realizimin e procesit si dhe publikimin e proceseve të ndjekura dhe rezultateve.

GP gjatë fazës së hartimit të SKS, ka për detyrë të konsultohet me të gjithë bazën ligjore të nevojshme që prek hartimin, përmbajtjen, administrimin, analizën përfundimtare të SKS. GP diskuton me Këshillat Studentorë fushat dhe indikatorët e vlerësimit, por jo pyetjet individuale të SKS. Në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të tyre, GP i reflekton ato në versionin përfundimtar të SKS.

Përmbajtja e SKS organizohet sipas strukturës së standardeve të sigurimit të cilësisë dhe fokusohet në indikatorë/kategori që kanë impakt në cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjen e studentëve. Struktura e SKS organizohet sipas tabelës 1.

**Tabela 1. Shembull i strukturës për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve**

Fushat e organizimit të SKS	Indikatorët/kategoritë për secilën fushë	Shembuj pyetjesh për indikatorë të veçantë
1. Organizimi i institucionit, menaxhimi dhe funksionimi i tij	Organizimi	Pyetjet në këtë indikator përfshijnë informacione që studenti ka për organizimin e IAL dhe mendimi i tij në lidhje me këtë strukturë (fakultete, departamente, njësitë administrative etj)
	Menaxhimi	Pyetje që përfshijnë informacione që studenti ka për menaxhimin e IAL dhe mendimi i tij në lidhje me aktivitetin e strukturave drejtuese
	Bashkëpunimi	Pyetje që përfshijnë informacione që studenti ka për bashkëpunimin e IAL në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mendimi i tij në lidhje me produktin dhe përfshirjen e studentëve
	Vendimmarrja	Pyetje që përfshijnë informacione që studenti ka për vendimmarrjen në IAL dhe vlerësimi i tij për përfshirjen e studentëve në të
	Transparenca	Pyetje që përfshijnë informacione që studenti ka për transparencën në IAL dhe vlerësimi i tij për transparencën
2. Burimet	Infrastruktura fizike	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për infrastrukturën në IAL, kushtet e mjediseve fizike në funksion të aktivitetit akademik e social
	Infrastruktura didaktike/logjistike	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për sallat, laboratorët, librarinë etj
	Stafi akademik	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për stafin akademik dhe të mbështetës, gadishmërinë dhe suportin e tyre
	Kapacitetet administrative / financiare	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për aspekte financiare në marrëdhëniet studentit me IAL dhe mbështetja për KS
3. Kurrikulat, përmbajtja dhe përditësimi	Organizimi i programeve	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për përmbajtjen dhe informimin e studentëve për programet e studimit
	Shpërndarja e veprimtarive mësimore	Pyetje që përfshijnë informacione dhe mendime të studentit në lidhje me raportet e veprimtarive mësimore e shkencore
	Literatura	Pyetje që përfshijnë informacione dhe vlerësime që studenti ka për aksesin në literaturë e nevojshme dhe ndihmëse, e printuar dhe <i>online</i>
4. Mësimdhënia, mësimnxënia,	Metodat e mësimdhënies	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studenti ka për metodologjinë e mësimdhënies

vlerësimi	Metodat e mësimnxënies Vlerësimi	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për mësimnxënien, vlerësimin dhe transparencën
	Kompetencat	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për njohuritë që fiton dhe sa ato i zhvillojnë atij kompetencat e nevojshme
5. Aktiviteti kërkimor, projekte studime, botime	Studime dhe analiza Kërkime	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për mbështetjen në fushën e kërkimit dhe ideve të reja
	Botime, publikime aktivitete dhe projekte	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për mbështetjen në botime, aktivizimin në projekte, mobilitete
6. Studentët dhe mbështetja e tyre	Regjistrimi dhe administrimi	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për informacionin para regjistrimit, gjatë regjistrimit dhe mënyrën e administrimit të procesit të regjistrimit
	Studenti në IAL	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për mbështetjen e tij nga IAL gjatë kryerjes së studimeve
	Punësimi dhe mbështetja nga ana e institucionit	Pyetje që përfshijnë mendime dhe vlerësime që studentit ka për mbështetjen e tij nga IAL për përgatitjen për tregun e punës dhe punësimin

SKS mund të organizohet në një pyetësor të vetëm ose mund të ndahet në disa pyetësorë sipas fushave. Kjo ndarje kryhet nëse numri i pyetjeve është relativisht i madh dhe koha e nevojshme për plotësimin e SKS është më shumë se 20 minuta. Në këtë rast periudha e parashikuar për shpërndarjen e SKS *online*, ndahet në disa periudha në bazë të numrit të pyetësorëve në përbërje të SKS. Edhe në këtë rast, kjo ndarje miratohet nga BA.

Nëçdo pyetje të SKS, studentit përgjigjet me mendim/vlerësim, po/jo ose tekst të shkurtër përshkrimor. Në përgjithësi pyetjet do të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që studentit të japë mendim/vlerësim të klasifikuar në 5 nivele duke filluar nga vlerësimi minimal nëmaksimal/shumë mirë ose nuk pranoj/miratoj/jam dakord në plotësisht dakord, etj. Konkretisht:

- Vlerësimi 1 – keq / aspak dakord
- Vlerësimi 2 – jo mirë / fare pak dakord
- Vlerësimi 3 – mirë / pjesërisht/ as pro as kundër
- Vlerësimi 4 – mjaftueshëm / kryesisht dakord
- Vlerësimi 5 – shumë mirë / plotësisht dakord

Në rastet kur pyetjet kanë nevojë për përgjigje me *po/jo* ose *tekst*, këto kuantifikohen dhe analizohen për rezultatin përfundimtar.

#### 4.4. Fazat e zhvillimit të SKS, procedura hap pas hapi

Miratimi i periudhës së zhvillimit të SKS bëhet me vendim të BA pas propozimit të ASCAL. Si rregull, përveç rasteve kur procesi iniciohet nga ministria përgjegjëse apo sondazhi ka qëllime të tjera, ASCAL nis procesin e zhvillimit në fillim të vitit akademik.

Në tërësi, i gjithë procesi shtrihet në një vit akademik dhe përmban tre faza:

##### Faza e parë

Bazuar në Manualin e SKS, titullari i ASCAL nis procedurën për hartimin Projekt propozimin për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studenteve. Në këtë kuadër mund të kërkohet edhe angazhimi i ekspertëve të fushës të cilët asistojnë ASCAL në përgatitjen e projektit me periudhën e aktiviteteve të detajuara.

Për këtë arsye, periudha më e përshtatshme për hartimin dhe miratimin e planit të aktiviteteve në kuadër të SKS është **shtator – tetor i vitit paraardhës**. Plani i detajuar i **dorëzohet për shqyrtim** Bordit të Akreditimit.

BA pasi shqyrton planin e propozuar, miraton ose propozon ndryshime eventuale të tij. Në çdo rast, **BA me vendim të posaçëm**, miraton planin dhe kalendarin e aktiviteteve dhe ngarkon ASCAL për zhvillimin e tij. Agjencia **bën publik** planin e miratuar.

##### Faza e dytë

Pas miratimit të planit të aktiviteteve, titullari i ASCAL **ngre Grupin e Punës (GP)** dhe **cakton koordinatorin** për zhvillimin e SKS, **informon institucionet** e arsimit të lartë, qeveritë dhe/ose këshillat studentore dhe **bën publik planin e detajuar** të aktiviteteve.

GP, bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, **harton procedurën** e zhvillimit të SKS. Gjatë kësaj faze hartohen dhe miratohen fushat dhe pyetësorët. ASCAL dhe GP është përgjegjës për zhvillimin e SKS në përputhje me procedurën e miratuar. Për këtë arsye ASCAL **garanton ecurinë** e procesit duke vënë në dispozicion të GP, **infrastrukturën e nevojshme logjistike**, burimet njerëzore dhe financiare.

**Pas miratimit** të procedurës së zhvillimit të SKS sondazhit të studentëve, GP harton **dokumente trajnimi** dhe **trajnojnë** studentët në institucionet e arsimit të lartë në bazë të një kalendari të miratuar paraprakisht.

Po ashtu, gjatë kësaj faze përgatitet **versioni on line** i sondazhit në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), mbledhen **të dhënat dhe kontaktet** e studentëve nga koordinatorët e IAL. Krijohen llogaritë për akses personal për të gjithë studentët që marrin pjesë në sondazh dhe bëhen testet paraprake të funksionimit të tij.

Pasi sigurohet funksionimi i plotë, **fillon shpërndarja** e pyetësorit on line për studentët duke lënë aktiv llogaritë e studentëve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e aktiviteteve.

E gjithë kjo fazë e rëndësishme kërkon angazhimin e të gjithë stafit të ASCAL, ekspertëve si dhe infrastrukturë të posaçme për garantimin e procesit (shih paragrafin 5)

## Faza e tretë

Faza e tretë është faza finale e procesit e cila nis **me mbylljen e aksesit** në pyetësor. GP përgatit **infrastrukturën** për mbledhjen e të dhënave nga pyetësorët e plotësuar, **shkarkon** të dhënat dhe **bën filtrimet** e duhura në databazë. Më pas **kryhen përpunimet statistikore** sipas përcaktimeve të Manualit si dhe **përgatit materialet** me rezultatet paraprake, përgatit **raportet përmbledhëse** e analitike si dhe harton **raportin final** me rezultatet përfundimtare të procesit, **informon** ASCAL dhe BA, **bën publike** rezultatet dhe **përmbyll procesin**. Hapat konkretë, sipas secilës Fazë janë si më poshtë:

Fazat e zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve	
Aktivitetet që zhvillohen	
<b>FAZA I</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Titullari i ASCAL nis procesin për realizimin e SKS për vitin akademik 2018 – 2019.</li> <li>• Nis puna për hartimin e Projekt propozimit për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studenteve.</li> <li>• Angazhohen ekspertë të fushës të cilët asistojnë ASCAL në përgatitjen e projektit me periudhën e aktivitete të detajuara.</li> <li>• Plani i detajuar i dorëzohet për shqyrtim Bordit të Akreditimit.</li> <li>• BA shqyrton planin e propozuar, miraton ose propozon ndryshime eventuale të tij.</li> <li>• BA me vendim të posaçëm, miraton planin dhe kalendarin e aktiviteteve dhe ngarkon ASCAL për zhvillimin e tij.</li> <li>• Agjencia bën publik planin e miratuar.</li> <li>• Titullari i ASCAL ngre Grupin e Punës dhe cakton Koordinatorin e procesit</li> </ul>
<b>FAZA II</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ASCAL &amp; BA zhvillojnë takime me titullarët e institucioneve / Rektorët për fillimin e procesit për SKS dhe njohjen me qëllimin e tij</li> <li>• ASCAL informon institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe/ose Këshillat studentore</li> <li>• Bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, hartohet dhe miratohet procedura e zhvillimit të SKS.</li> <li>• Hartohen dhe miratohen fushat dhe pyetësorët.</li> <li>• ASCAL siguron infrastrukturën e nevojshme logjistike, burimet njerëzore dhe financiare.</li> <li>• Hartohen dokumente trajnimi</li> <li>• Kontaktohen koordinatorët e institucioneve, drejtuesit e këshillave studentore</li> <li>• Kërkohen kontaktet e studentëve, Dip_2vj.(v2), BSc.(v2,v3), Mp, MSc.(v1,v2)</li> <li>• Hartohet kalendari i trajnimeve për studentët në institucionet e arsimit të lartë dhe informohen drejtuesit e studentëve dhe KI</li> <li>• Diskutohen me këshillat studentorë fushat dhe indikatorët e SKS</li> <li>• Reflektohen propozimet eventuale të KS kur ato janë të vlefshme dhe finalizohet versioni final i SKS.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnohen studentët për mënyrën e plotësimit, qoftë me takime përmbledhëse apo vizita në institucione të caktuara sipas kërkesave nga IAL dhe planit paraprak.</li> <li>• Kontaktohen koordinorët e institucioneve për bashkëpunim me studentët dhe informimin e tyre</li> <li>• GP dhe ASCAL përgatit infrastrukturën logjistike (për sondazhin on line)</li> <li>• Përgatitet versioni <i>online</i> i SKS në shqip</li> <li>• Përgatitet versioni <i>online</i> i SKS në anglisht</li> <li>• Përgatiten formatet e komunikimeve me studentët dhe vendosen afatet on line</li> <li>• Kryhen testet e nevojshme,</li> <li>• Krijohen llogaritë për akses individual on line etj</li> <li>• Njoftohen paraprakisht këshillat studentorë dhe koordinorët e IAL për shpërndarjen e pyetësorëve</li> <li>• Shpërndahen pyetësorët,</li> <li>• GP /ASCAL ndjek ecurinë e plotësimit të sondazhit</li> <li>• Asiston studentët në zgjidhjen e problematikave të ndryshme</li> </ul>
<b>FAZA III</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbyllet aksesit <i>online</i>,</li> <li>• Mblidhen të dhënat dhe bëhen filtrimet e mundshme</li> <li>• Përgatiten të dhënat për përpunime statistikore</li> <li>• GP përgatit infrastrukturën për përpunimet statistikore sipas përcaktimeve të Manualit</li> <li>• Nxirren rezultatet individuale për çdo IAL</li> <li>• Hartohen tabelat përmbledhëse për analiza krahasuese për indikatorë të ndryshëm</li> <li>• Përgatiten dhe finalizohen rezultatet individuale për çdo IAL</li> <li>• Përgatiten informacione shtesë për IAL dhe së bashku me rezultatet e sondazhit për çdo fushë, indikator dhe pyetje bëhen pjesë e raporteve apo për publikohen</li> <li>• Hartohet raporti përmbledhës për të gjitha IAL me rezultate krahasuese për fusha dhe indikatorë të veçantë.</li> <li>• Analizohet cilësia e mësimdhënies në bazë të rezultateve,</li> <li>• Nxirren konstatime dhe problematika</li> <li>• Propozime nga GP për përmirësime në të ardhmen</li> <li>• Hartohet raporti final (Përmbledhja e të gjitha informacioneve të nevojshme për shqyrtim, përfshirë metodologjinë, ecurinë e plotë, rezultatet individuale dhe raportin përmbledhës).</li> <li>• Dokumentacioni i plotë shqyrtohet nga BA në mbledhjen e radhës që zhvillohet në këtë periudhë.</li> <li>• BA analizon rezultatet, përfundimet, gjetjet, propozimet dhe merr vendime respektive</li> <li>• GP dhe ASCAL përgatit platformën dinamike on line për publikimin e rezultateve për kërkim interaktiv</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ASCAL publikon të gjitha raportet, rezultatet dhe vendimet e BA</li> <li>• Raportet dërgohen zyrtarisht në IAL dhe në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë, së bashku me vendimmarrjen dhe rekomandimet përkatëse</li> <li>• Mbyllet procesi i zhvillimit të SKS dhe arkivohet informacioni / dokumentacioni</li> </ul>
--	--

Për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve aprovohet në ASCAL/BA “Plani i detajuar i veprimit”

Studentët gjatë gjithë procesit kanë asistencën e nevojshme për sqarime, informacione dhe suport teknik nga GP, stafi i ASCAL dhe KI. GP vë në dispozicion të tyre udhëzues, informacione dhe portalin *online* për sqarimet e duhura. Po ashtu institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshme në lidhje me rëndësinë që ka aktivizimi i studentëve në menaxhimin e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe mjedisit të të mësuarit, si dhe nevojën për përfaqësimin e gjerë të tyre. Ato krijojnë dhe ofrojnë të gjitha facilitetet e duhura për studentët për plotësimin e SKS në IAL, nëse është e nevojshme.

## 5. Administrimi dhe menaxhimi i të dhënave, analiza dhe rezultate

### 5.1. Të dhënat dhe baza e të dhënave

ASCAL dhe BA nëpërmjet SKS mbledhin informacion dhe të dhëna për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, në bazëtë fushave dhe indikatorëve të përcaktuar më sipër. Çdo informacion i marrë përdoret vetëm për qëllimin e nisur. Pas përfundimit të procesit ato arkivohen dhe ruhen në ASCAL në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin dhe ruajtjen e të dhënave. Versioni *online* administrohet dhe menaxhohet nga IT i ASCAL, i cili është njëkohësisht pjesë e grupit të punës. Çdo veprim në lidhje me bazën e të dhënave, kryhet vetëm me miratimin e KP. Procesi i hartimit të bazës së të dhënave, publikimi, editimet e ndryshme, korigjimet eventuale, aksesit, kodet, përgjigjet, administrohen nëpërmjet një protokollit të posaçëm, i cili parashikon dokumentimin e çdo veprimi që kryhet në të. Kjo ecuri arkivohet dhe bëhet pjesë e procesit të SKS. Aksesit në bazën e të dhënave është i limituar dhe mundësohet vetëm me anën e kodit, duke i mundësuar akses vetëm personit të autorizuar nga KP. baza e të dhënave, në versionin *online* me listën e pjesëmarrësve, *e-mail* dhe përgjigjet individuale ruhet në formatin SQL/MySQL. Më pas eksportohet në formate të tjera për përpunime statistikore (Excel, Access, SPSS etj). Në çdo rast, eksportimi dhe ruajtja e të dhënave bëhet duke informuar KP dhe personin/personat që iu vihet në dispozicion, pjesë e GP. Në përfundim të procesit, baza e të dhënave me përgjigjet individuale, ruhet dhe arkivohet në formën elektronike në sistemin e menaxhimit të ASCAL.

### 5.2. Transparenca, anonimatit dhe konfidencialiteti

Informacioni i marrë nga studentët, është mendimi dhe vlerësimi individual i secilit prej tyre për institucionin ku ata studiojnë, në lidhje me indikatorët e vlerësimit. Përpara plotësimit të pyetësorit, çdo student është i mirëinformuar në lidhje me këtë sondazh, mënyrën e organizimit të tij, metodologjinë dhe qëllimin për të cilin ai realizohet. Po ashtu, studentët informohen mbi procedurën që ndiqet dhe të dhënat që merren. Çdo fazë duhet të jetë e qartë dhe e bërë publike në takime të drejtpërdrejta, udhëzues të ndryshëm, faqen e internetit etj. SKS do të ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht)<sup>2</sup> për t'u dhënë mundësi plotësimi studentëve vendas dhe të huaj. Pyetësoi nuk kërkon të mbledhë të dhëna individuale për studentin, por mendimin e tij për institucionin. Përgjigjet janë individuale, por ato nuk identifikohen me emrin.

Të dhënat për studentët (emri dhe *e-mail*) sigurohen zyrtarisht ngainstitucionet e arsimit të lartë dhe i vihen në dispozicion ASCAL nga KI. Emri dhe *e-mail* i çdo studenti përdoren vetëm për dërgimin e pyetësorit në llogarinë e tij (*link-u* për akses të pyetësorit dhe kodi për akses). Më pas çdo student ka ID e vet në SKS dhe përgjigjet e tij lidhen më këtë ID dhe jo me emrin e tij. Analiza e përgjigjeve kryhet në mënyrë statistikore dhe po ashtu rezultatet janë përmbledhje të përgjigjeve për indikatorë dhe pyetje të ndryshme. Në asnjë rast nuk identifikohet përgjigja me ID apo emrin e individit. ASCAL garanton anonimatit dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve duke filluar nga dërgimi i aksesit në *e-mail*-in personal, deri në përpunimin e rezultateve. Çdo pjesëmarrës në sondazh ka të drejtën e marrjes ose jo pjesë. Çdo individ i merret mendimi

---

<sup>2</sup>Mund të parashikohet edhe gjuhë tjetër nëse është e nevojshme



vetëm njëherë në një pyetësor të caktuar. Në rastet kur ai kërkon të ndryshojë mendimet/përgjigjet e veta, nëpërmjet *e-mail*-t kërkon të fshihen përgjigjet e mëparshme dhe ti jepet akses i ri për të riplotësuar SKS. Kjo procedurë mund të ndodhe vetëm gjatë fazës që SKS është *on-line* dhe në asnjë rast tjetër. Me përfundim të periudhës në të cilën SKS është *on-line*, asnjë individ nuk kontaktohet apo ripyetet për saktësimin e informacionit.

### 5.3. Përpunimi paraprak dhe analiza e rezultateve

Pas përfundimit të fazës së plotësimit *online*, SKS mbyllet dhe administrohet nga GP. Analizohen të dhënat paraprake për çdo IAL në mënyrë që SKS të plotësojë kriteret minimale statistikore të përpunimit dhe besueshmërisë së tij. Eleminohen përgjigjet jo në përputhje me këtë manual apo përgjigjet në pyetje të cilat kanë pjesëmarrje të ulët. Nëçdo rast, për çdo IAL, GP harton tabelën përmbledhëse në të cilën përshkruhen qartë të gjitha të dhënat numerike dhe nëpërçindje, të regjistruara në bazën e të dhënave dhe ato të marra në konsideratë për tu analizuar, pas filtrimit paraprak. Për përpunime statistikore, GP përdor programe të ndryshme të cilat mundësojnë një analizë sa më të gjerë të të dhënave si dhe mundësi të shumta vizualizimi dhe paraqitjeje grafike. Analiza e të dhënave kryhet në përputhje me qëllimin që ka SKS. Rezultatet paraqiten në mënyrë të përmbledhur për çdo fushë dhe e detajuar për indikator dhe pyetje. Në përfundim të këtij procesi, GP përgatit rezultatet analitike për raportin final (rezultate numerike, tabelore e grafike) për çdo institucion.

### 5.4. Rezultatet dhe vlerësimi

Rezultati i SKS në nivel institucional apo kombëtar analizohet me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies sipas fushave dhe indikatorëve. Në bazë të përgjigjeve të, GP nxjerr vlerësime për indikatorët dhe fushat e vlerësimit. Ky vlerësim ndahet në 3 grupe:

- **Jo mirë** – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim keq dhe /ose jo mirë,
- **Mirë** – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur deri në 60 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim mirë, mjaftueshëm dhe /ose shumë mirë,
- **Shumë mirë** – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim shumë mirë,

Në bazë të vlerësimit të indikatorëve dhe fushave të vlerësimit, GP nxjerr vlerësimin final të cilësisë së mësimdhënies në një institucion të caktuar, i cili po ashtu klasifikohet në tre nivele:

Cilësia e mësimdhënies në një institucion të arsimit të lartë konsiderohet:

- **Jo mirë** – kur të paktën 5 fusha vlerësimi janë vlerësuar jo mirë
- **Mirë** – kur të 6 fusha vlerësimi janë vlerësuar mirë, 5 mirë dhe 1 shumë mirë, 4 mirë dhe 2 shumë mirë, 3 mirë dhe 3 shumë mirë, 2 mirë dhe 4 shumë mirë, 1 mirë dhe 5 shumë mirë.
- **Shumë mirë** - kur të 6 fushat e vlerësimit janë vlerësuar shumë mirë.

## 5.5. Rezultatet analitike përçdo IAL

Rezultatet analitike janë informacionet kryesore që përgatiten nga GP për secilin institucion, pjesëmarrës në SKS dhe përmban të gjithë të dhënat e nevojshme për studentët dhe publikun në lidhje me:

- Institucionin e arsimit të lartë, të dhëna të përgjithshme për fushën e veprimtarisë, organizimin, strukturën, statistika për programet e studimit, stafin akademik
- Tabelën përmbledhëse të SKS me të dhëna për ecurinë , kronologjinë, pjesëmarrjen, përgjigjet e plota e të pjesshme etj
- Rezultatet analitike për çdo pyetje të shfaqur në formë tabelore dhe numerike
- Vlerësimin përfundimtar në lidhje me cilësinë e mësimdhënies të dalë nga SKS

Rezultatet analitike bëhen pjesë e raportit final dhe pasi shqyrtohen nga BA, publikohen *on-line*

## 5.6. Raporti përmbledhës

Raporti përmbledhës hartohet nga GP me qëllim paraqitjen e cilësisë së mësimdhënies në arsimin e lartë në nivel kombëtar.

Ky raport përmban:

- informacione të përgjithshme statistikore për institucionet, programet e studimit, në nivel kombëtar, të dhëna këto që sigurohen nga baza e të dhënave e ASCAL
- rezultate të SKS për të gjitha IAL për pyetje, të indikatorëve dhe fushave të vlerësimit.

Raporti hartohet në gjuhën shqipe. Pasi shqyrtohet nga BA, publikohet *on-line* dhe dërgohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

## **6. Shqyrtimi, vendimmarrja dhe publikimi i rezultateve të SKS**

### **6.1. Shqyrtimi nga BA**

Pasi GP ka përgatitur dokumentacionin e plotë, e dorëzon atë në BA për shqyrtim. BA mund të kërkojë edhe informacione shtesë që lidhen me procedurën dhe zhvillimin e SKS. BA shqyrton dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në rastet kur ai është i plotë dhe i mjaftueshëm, miraton atë dhe vendos për publikimin e rezultateve në portal dhe faqen zyrtare të ASCAL. Në rast problematikash, BA propozon ndryshme/përmirësime të kuadrit ligjor dhe politikëbërjes për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë. BA në bazë të rezultateve të SKS, kur nuk garantohet cilësia në mësimdhënie, kërkon nga ASCAL nisjen e proceseve të ndryshme të monitorimit në institucione të caktuara. Rezultatet e SKS, raporti analitik, vendimmarrja dhe rekomandimet e BA, bëhen publike në përfundim të procesit.

Në rastet kur BA ka nevojë për informacione shtesë, kërkon nga ASCAL dokumente, analiza etj, në funksion të një tematike të caktuar.

### **6.2. Publikimi i rezultateve**

ASCAL bën publike të gjitha informacionet që lidhen me sondazhin kombëtar të studentëve. Në një portal të posaçëm, do të jepen informacionet, dokumentet, rezultatet dhe raportet përfundimtare që lidhen me këtë proces.

Pjesë e këtij portali është moduli i ndërvëprimit, me mundësi për kërkim të personalizuar, në bazë të interesit dhe fokusit që ka secili i interesuar. Përzgjedhja e informacionit bazohet në metodologjinë dhënies së informacionit të dalë nga rezultatet e sondazhit. Kjo metodë përdoret sot gjërësisht dhe u vjen në ndihmë veçanërisht studentëve të rinj të cilët kërkojnë të vendosin për institucionin se ku do të studiojnë në të ardhmen.

## 7. Përkufizime dhe shkurtime

ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, institucion publik, pjesë e sigurimit të cilësisë, përgjegjëse për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit dhe garantimit të standardeve të cilësisë në AL

BA – Bordi i Akreditimit. Organ kolegjal vendimmarrës për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në arsimin e lartë

MASR– Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë

LAL – Ligji i arsimit të lartë 80/2016

IAL – Institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

SC - Standardet e Cilësisë në arsimin e lartë, akreditimin e IAL dhe programeve të studimit. Këto standarde janë pjesë integrale e Kodit të Cilësisë në AL

KC – Kodi i Cilësisë në AL është tërësia e dokumenteve ligjore, udhëzues, procedura, standarde të hartuara në funksion të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë, në arsimin e lartë.

KI - Koordinator Institucional është personi kyç, përfaqësues i IAL, i cili mban kontakte të vazhdueshme me ASCAL në kuadër të zhvillimit të proceseve të ndryshme në fushën e sigurimit të cilësisë në AL

KS – Këshilli Studentorë është organizëm i studentëve që funksionojnë në IAL sipas përcaktimeve të LAL, 80/2015

SKS – Sondazhi Kombëtar i Studentëve është proces në kuadër të vlerësimit të mësimdhënies në AL dhe realizohet çdo tre vjet nga ASCAL dhe BA

Pyetësor – Tërësia e pyetjeve që u drejtohen studentëve të përfshira në SKS

Procedura – Dokumente të posaçme që hartohen me qëllim mbarëvajtjen e procesit apo orientimin dhe informimin e studentëve

Indikatorët e vlerësimit – Tregues / orientues në një drejtim i caktuar të operimit dhe funksionimit të IAL sipas të cilit organizohen pyetjet

Baza e të dhënave – Tërësia e të dhënave, informacioneve, rezultateve që mblidhen dhe prodhohen gjatë zhvillimit të SKS

Rezultate paraprake – Janë informacione dhe të dhëna që dalin nga përpunimi i përgjigjeve të studentëve gjatë zhvillimit të SKS

Raport analitik – Është dokumenti kryesor që del në përfundim të SKS, i cili përmban të gjithë informacionet e nevojshme për institucionet, programet dhe rezultatet e SKS